



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/ 2018

**V E N D I M**

**Nr. 100 , Datë 05 / 04 / 2018**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në nenin 32, pika 1, germa c), të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, si dhe bazuar në Urdhërin nr.64, datë 25.05.2017<sup>1</sup>, filloi procedurën e shqyrtimit kryesisht të çështjes.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I :**

**I. Parashtrimi i fakteve.**

Komiteti Shqiptar i Helsinkit<sup>2</sup> informon Komisionerin lidhur me problematikën e hasur gjatë trajtimit të kërkesave/ankesave të të burgosurve apo nga monitorimet e kryera prej tyre në burgje. Kështu, në shkresën e tyre citohet se: “... *IEVP-të nuk zbatojnë të njëjtën praktikë sa i takon njohjes së punës së të dënuarve dhe përfitimit të shpërblimit lidhur me të. KSHH konstaton se është ende në zbatim ligji i vjetër<sup>3</sup> sa i takon mënyrës së shpërblimit të punës së të dënuarve, dmth 3.9 ditë në muaj i zbritet dënimit të tyre. Progres Raporti i vitit 2015 për Shqipërinë shprehet se dhe ata pak të burgosur që punojnë marrin ulje të dënimit dhe jo shpërblim. Ligji parashikon se puna shpërblehet dhe pagesa jepet si shpërblim në raport me punën e kryer, konform rregullave që përcaktohen në VKM përkatëse. Sipas akteve ligjore dhe nënligjore, personat e dënuar që punojnë punë të ndryshme brenda organikës së burgut shpërblehen me*

<sup>1</sup> Urdhër nr.64, datë 25.05.2017 “Për fillimin e procedurave për ndjekjen “ex-officio” të çështjes së përlogaritjes së punës së kryer të të dënuarve me burgim”.

<sup>2</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KSHH.

<sup>3</sup> Dekreti nr.7289, datë 08.04.1989 “Për zbritjen e dënimit të personave të dënuar me heqje lirie, që aktivizohen në punë, kur plotësojnë e tejkalojnë normën”.

pagë minimale, sipas kriterëve të përcaktuara me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave. Ata konsiderohen “punëmarrës” dhe duhet të trajtohen në përputhje me parashikimet e bëra në Kodin e Punës, i ndryshuar. Në gjithsej 23 burgje të RSH punojnë një numër i konsiderueshëm i personave të dënuar me burgim. Ata nuk trajtohen nga administrata e burgjeve njësoj si shtetasit e tjerë të punësuar jashtë burgjeve, në përputhje me legjislacionin e mësipërm të punës apo të trajtimit të personave të burgosur (për të drejtën e mbrojtjes së shëndetit, sigurisë në punë, kohëzgjatjes së punës, shpërblimit për punën, ditët e pushimit etj). KSHH ka konstatuar se, për punën e kryer në burgje janë krijuar dy praktika: administrative dhe gjyqësore lidhur me përfutimin nga puna. Një pjesë e personave të dënuar që punojnë në burgje shpërblehen sipas Vendimit nr.228, datë 19.05.1993 “Për mënyrën e shpërblimit të punës së të dënuarve me heqje lirie”, të Këshillit të Ministrave, duke u shpërblyer me një shumë prej 90(nëntëdhjetë)lekësh të rinj/muaj, megjithëse ky akt është miratuar përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr.8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar. Ndërsa, sipas këtij ligji, të dënuarit që punojnë duhet të trajtohen sipas parashikimeve të Kodit të Punës dhe të paguhen me pagë minimale. Nga ana tjetër, pjesa më e madhe e të dënuarve me burgim që punojnë punë të ndryshme në burgje përfutojnë ulje dënimi rreth 3.9 ditë/muaj punë sipas Dekretit nr.7289, datë 08.04.1989 “Për zbritjen e dënimit të personave të dënuar me heqje lirie, që aktivizohen në punë, kur plotësojnë e tejkalojnë normën”, të Presidiumit të Kuvendit Popullor, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për punësimin e të burgosurve”.

Në këtë këndvështrim, për sa më sipër, KSHH pretendon se personat e dënuar që kryejnë punë të ndryshme në burg, nuk trajtohen njëllor dhe janë të diskriminuar në raport me shtetasit e tjerë të punësuar jashtë burgut.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, **gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore**, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen

*shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr.403/5 prot, datë 25.05.2017 ju kërkua informacion Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve ,lidhur me pretendimin e ngritur nga KSHH.

Me shkresën me nr.4659/1 prot., datë 08.06.2017, Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, informon Komisionerin, se: *“...Bazuar në nenin 34, të Ligjit nr.8328/1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar, nenit 54 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve<sup>4</sup> ka hartuar dhe përcjellë në adresë të Ministrisë së Drejtësisë për konsultim të mëtejshëm draftin e Projekt-Vendimit “Për nxitjen dhe shpërblimit të punës të burgosurve<sup>5</sup>. Për hartimin e këtij projekt-vendimi, DPB është konsultuar me bazën ligjore ekzistuese që rregullon marrëdhëniet e punës në Republikën e Shqipërisë, si dhe Rekomandimet e Këshillit të Evropës mbi punësimin në sistemin e burgjeve”.*

2. Me shkresën nr.884 prot., datë 13.09.2017 Komisioneri kërkoi informacion nga DPB dhe 23 IEVP në Republikën e Shqipërisë mbi numrin e përgjithshëm të të dënuarve të cilët punojnë në ambientet e IEVP-ve, a përfitojnë të dënuarit pranë IEVP-ve të tyre shpërblim me pagë për punën e kryer, sa është pagesa dhe numri i individëve që përfitojnë, etj.

Me shkresën nr.8380/1 prot., datë 27.09.2017 DPB informon Komisionerin se: *“Numri aktual i të burgosurve të përfshirë në të gjithë sistemin e burgjeve është 619 persona, ndër të cilët të dënuar të punësuar janë 476 dhe të paraburgosur të punësuar janë 143 persona. Dispozitat ligjore të miratuara pas viteve 1990 kanë rregulluar marrëdhënien e punës të të dënuarit me burgim, si një marrëdhënie juridiko-civile, në raport me mënyrën e shpërblimit të saj dhe përfitimeve të tjera përsa i përket vjetërsisë në punë, sigurimeve shoqërore etj. Dekreti nr.7289/1989 “Për zbritjen e dënimit të personave të dënuar me heqje lirie, që aktivizohen në*

---

<sup>4</sup>Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën DPB.

<sup>5</sup>Referuar shkresës me nr.1969 prot., datë 09.03.2017 dhe relacionin bashkëngjitur shkresës.

*punë, kur plotësojnë e tejkalojnë normën”, i Presidiumit të Kuvendit Popullor, ka mbetur në fuqi dhe nuk është shfuqizuar me asnjë akt ligjor dhe nënligjor. DPB ka adresuar në mënyrë të vazhdueshme këtë problematikë dhe në këtë kuadër ka hartuar dhe përcjellë në adresë të Ministrisë së Drejtësisë për konsultim të mëtejshëm draftin e Projekt-vendimit “Për nxitjen dhe shpërblimin e punës të burgosurve” dhe relacionin përkatës”.*

Me shkresat nr. 1511/1 prot., datë 18.09.2017 IEVP “Mine Peza” dhe me nr.3643 prot., datë 18.09.2017 IEVP Peqin, kanë informuar Komisionerin se: *“Të dënuarit me burgim dhe ata të para burgosur, të punësuar pranë këtyre IEVP-ve nuk kanë përfituar shpërblim me pagë minimale për punën e kryer prej tyre, por kanë përfituar uljen e dënimit me 3.9 ditë në muaj. Kjo për faktin se Dekreti nr.7289/1989 “Për zbritjen e dënimit të personave të dënuar me heqje lirie, që aktivizohen në punë, kur plotësojnë e tejkalojnë normën”, i Presidiumit të Kuvendit Popullor, ka mbetur në fuqi dhe nuk është shfuqizuar me asnjë akt ligjor dhe nënligjor”.*

### **III. Vlerësimi i Komisionerit, i fakteve dhe provave të grumbulluara, gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

Përsa më sipër, Komisioneri analizoi situatën e sjellë në vëmendje nga KSHH, parë kjo në respektim të zbatimit të Kushtetutës së R.SH, Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, si dhe legjislacionit<sup>6</sup>.

U konstatua se, lidhur me punën e kryer nga të dënuarit në burgje janë krijuar dy praktika: administrative dhe gjyqësore<sup>7</sup>.

---

<sup>6</sup>Të brendshëm dhe atij ndërkombëtar.

<sup>7</sup>- Një pjesë e personave të dënuar që punojnë në burgje shpërblehen sipas Vendimit nr.228, datë 19.05.1993 “Për mënyrën e shpërblimit të punës së të dënuarve me heqje lirie”, të KM, duke u shpërblyer në shumën prej 90 (nëntë dhjetë) lekësh të rinj/muaj, megjithëse ky akt është miratuar para hyrjes në fuqi të Ligjit nr.8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar. Kjo praktikë bie ndesh me parashikimet e këtij ligji, sipas të cilit të dënuarit që punojnë duhet të trajtohen sipas Kodit të Punës dhe të pagohen më një pagë minimale, sipas përcaktimeve të VKM-së përkatëse.

- Nga ana tjetër, pjesa më e madhe e të dënuarve me burgim që punojnë punë të ndryshme në burgje përfitojnë ulje dënimi rreth 3.9 ditë/muaj sipas Dekretit nr.7289, datë 08.04.1989 “Për zbritjen e dënimit të personave të dënuar me heqje lirie, që aktivizohen në punë, kur plotësojnë e tejkalojnë normën”, të Presidiumit të Kuvendit Popullor, gjë që bie në kundërshtim edhe me legjislacionin në fuqi për punësimin e të burgosurve.

Kjo situatë është evidentuar në kuadër të shqyrtimit të një ankesë të sjellë pranë Komisionerit nga KSHH<sup>8</sup>. Në gjithsej 23 burgje të RSH punojnë një numër i konsiderueshëm i personave të dënuar me burgim. Ata nuk trajtohen nga administrata e burgjeve njësoj si shtetasit e tjerë të punësuar jashtë burgjeve, në përputhje me legjislacionin e mësipërm të punës apo të trajtimit të personave të burgosur (për të drejtën e mbrojtjes së shëndetit, sigurisë në punë, kohëzgjatjes së punës, shpërblimit për punën, ditët e pushimit etj).

Komisioneri konstaton se, për punën e kryer në burgje janë krijuar dy praktika: administrative dhe gjyqësore lidhur me përfitimin nga puna. Një pjesë e personave të dënuar që punojnë në burgje shpërblehen sipas Vendimit nr.228, datë 19.05.1993 “Për mënyrën e shpërblimit të punës së të dënuarve me heqje lirie”, të Këshillit të Ministrave, duke u shpërblyer me një shumë prej 90(nëntëdhjetë) lekësh të rinj/muaj, megjithëse ky akt është miratuar përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr.8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar. Ndërsa, sipas këtij ligji, të dënuarit që punojnë duhet të trajtohen sipas parashikimeve të Kodit të Punës dhe të paguhen me pagë minimale. Nga ana tjetër, pjesa më e madhe e të dënuarve me burgim që punojnë punë të ndryshme në burgje përfitojnë ulje dënimi rreth 3.9 ditë/muaj punë sipas Dekretit nr.7289, datë 08.04.1989 “Për zbritjen e dënimit të personave të dënuar me heqje lirie, që aktivizohen në punë, kur plotësojnë e tejkalojnë normën”, të Presidiumit të Kuvendit Popullor, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për punësimin e të burgosurve”.

Lidhur me këtë problematikë, organet e drejtësisë si gjykata, prokuroria dhe administrata e burgjeve kanë lejuar që një pjesë e personave të dënuar me burgim të përfitojnë ulje apo shlyerje të kohës së dënimit, duke iu llogaritur atyre ditët e punës së kryer si ditë burgu, sipas kriterëve të dekretit të mësipërm.

Për sa më lart, referuar shkresës me nr.3233 prot., datë 08.10.2004 të Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, theksohet se, në kuadrin ligjor në fuqi nuk ka asnjë rregullim të veçantë sipas të cilit të lejohet konvertimi i ditëve të punës së kryer në burg për efekt të shlyerjes së dënimit. Edhe Dekreti nr.7289, datë 08.04.1989 “Për zbritjen e dënimit të personave të dënuar me heqje lirie, që aktivizohen në punë, kur plotësojnë e tejkalojnë normën”, të Presidiumit të Kuvendit Popullor, konsiderohet i shfuqizuar. Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm, me anë të kësaj shkrese

---

<sup>8</sup> Ankesa nr.27 Regj., datë 28.04.2017, e shtetasit R. R<sup>8</sup>,

urdhëroi prokurorët që marrin pjesë në gjykimin e çështjeve me objekt njohjen e ditëve të punës për efekt të uljes së dënimit të kërkojnë rrëzimin e kërkesës së të dënuarve si të pabazuar në ligj. Gjithashtu, urdhëroi që prokurorët që ndjekin ekzekutimin e vendimeve penale të ushtrojnë kontroll për evidentimin e rasteve të ngjashme dhe të urdhërojnë korigjimin e evidencave të administratës të burgjeve respektive për këtë praktikë të gabuar të njohjes së ditëve të punës për efekt të shlyerjes së dënimit.

Në këtë këndvështrim, për sa më sipër, Komisioneri vëren se personat e dënuar që kryejnë punë të ndryshme në burg, nuk trajtohen njëllor dhe janë të diskriminuar në raport me shtetasit e tjerë të punësuar jashtë burgut. Po ashtu, edhe vetë IEVP-të nuk operojnë në të njëjtën mënyrë, ndonëse parashikimet ligjore janë të njëjta për të gjitha institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale në Republikën e Shqipërisë. Pra, nuk kemi një praktikë të unifikuar dhe nga vetë këto institucione.

Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 1 sipërcituar dhe neni 3/1, parashikojnë se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Kështu, Kushtetuta si akti themeltar i Republikës së Shqipërisë, sanksionon se: *“Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme, të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik”.* Neni 18, i saj shpreh se *“1.Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit”.*

Po sipas nenit 116 të Kushtetutës, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore<sup>9</sup> është një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj dhe në hierarkinë e normave juridike renditet menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ajo zë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhet e detyrueshme për t’u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

---

<sup>9</sup> Në vijim do të referohemi me shkurtesën KEDNJ. Ajo është ratifikuar nga RSH me ligjin nr.8137, datë 31.07.1996.

Neni 14, i KEDNJ, “Ndalimi i diskriminimit”, përcakton se : *“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”*.

Ligji nr.8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar, në nenin 34 parashikon se: *“Të gjithë të paraburgosurve dhe të dënuarve u njihet e drejta për të punuar. Puna organizohet nga drejtoria e institucionit, brenda dhe jashtë tij, duke shfrytëzuar edhe ndihmën e subjekteve të tjera. Puna nuk ka karakter dënimi dhe shpërblehet sipas kritereve të përcaktuara me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave”*.

Megjithëse ligji sipërcituar, e ka të përcaktuar në mënyrë të qartë, se puna e të dënuarve shpërblehet dhe pagesa jepet si shpërblim në proporcion me punën e kryer, konform rregullave që përcaktohen në VKM, vërehet se vazhdon të zbatohet një praktikë e cila është në kundërshtim me parashikimet e legjislacionit në fuqi. Kjo është evidentuar dhe në Progres Raportin për Shqipërinë për vitin 2015<sup>10</sup> si dhe tek “Raporti mbi situatën e të drejtave të njeriut, të personave të privuar nga liria në komisariatet e Policisë së Shtetit, në Institucionet e paraburgimit dhe të ekzekutimit të vendimeve penale dhe në spitalet psikiatrike, për periudhën Korrik 2015-Janar 2016” i KSHH-së.

Po t’i referohemi këtyre dy raporteve, të dënuarit që punojnë vijojnë të marrin ulje të dënimit dhe jo kompensim. Në këtë mënyrë vijonë të zbatohen ende parashikimet e Dekretit nr.7289, datë 08.04.1989 “Për zbritjen e dënimit të personave të dënuar me heqje të lirisë, që aktivizohen në punë, kur plotësojnë e tejkalojnë normën”, të Presidiumit të Kuvendit Popullor. Kjo praktikë është tërësisht e papërshtatshme për personat e paraburgosur dhe të dënuarit me heqje lirie, si dhe në shkelje të parashikimeve ligjore. Po në këtë kuadër, ata nuk janë të pajisur me librezë pune dhe as me librezë të kontributeve shoqërore. Në këtë këndvështrim atyre nuk iu paguhet vlera përkatëse e sigurimeve shoqërore, çka sjell më pas dhe mosvlerësimin e kohës së punës në institucion si kohë vjetërsie në punë.

---

<sup>10</sup> Referuar Progres Raportit për Shqipërinë për vitin 2015.

Në nenin 5/2 të Ligjit nr.8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar, thuhet se: *“Të dënuarit dhe të paraburgosurit trajtohen pa njëanshmëri dhe pa diskriminim mbi bazë gjinie, race, ngjyre, përkatësie etnike, gjuhe, feje, bindjeje politike, fetare ose filozofike, orientimi seksual, identiteti gjinor, gjendjeje ekonomike, arsimore ose shoqërore, përkatësie prindërore, moshe, gjendjeje familjare ose martesore, gjendjeje shëndetësore, aftësie të kufizuar, shtetësie ose përkatësie në një grup të veçantë ose për çdo shkak tjetër që përbën diskriminim”.*

E njëta mbrojtje nga diskriminimi për personat e dënuar me burgim garantohet edhe në nenin 2, pika 2, të VKM nr.437, datë 20.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”. Në nenin 54 të kësaj VKM-je thuhet se: *“Aktet ligjore dhe nënligjore që shërbejnë për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë, mirëqenies sociale dhe kohëzgjatjes në punë, si dhe ato që rregullojnë marrëdhëniet e punës, me përjashtim të ushtrimit të së drejtës për grevë dhe pjesëmarrje në sindikata, zbatohen edhe për të burgosurit e të dënuarit”.*

Në pikën 2, të VKM –së nr.396, datë 27.07.2000 “Për njohjen e periudhës së sigurimit për efekt pensioni dhe aksidenti në punë të të dënuarve me burgim”, thuhet se: *“Paga, për të cilën i dënuari do të sigurohet, nuk mund të jetë më e ulët se paga minimale e vitit përkatës, e cila caktohet me VKM”.*

Në Rekomandimin (2006)2, të Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi “Rregullat Evropiane të Burgjeve”, thuhet se:

*“26.7 Organizimi dhe metodat e punës në institucione, janë sa më shumë të jetë e mundur, të ngjashme me të njëjtën punë në komunitet në mënyrë që të burgosurit të përgatiten për kushtet e një jete normale pune.*

*26.9 Puna për të burgosurit jepet nga autoritetet e burgut, ose në bashkëpunim me kontraktorë privatë, brenda dhe jashtë burgut.*

***26.10 Në të gjitha rastet puna e të burgosurve shpërblehet me pagesën e duhur.***

***26.13 Masat e sigurimit shëndetësor dhe teknik për të burgosurit duhet t’i mbrojnë ata në mënyrë të mjaftueshme dhe nuk duhet të jenë masa më pak rigoroze sesa masat e përdorura për punëtorët jashtë burgut.***



*26.14 Në raste të dëmtimeve të rënda, duke përfshirë edhe sëmundjet profesionale, për të dëmshpërblyer të burgosurit ka dispozita të veçanta, kushtet e të cilave nuk janë më pak të favorshme sesa kushtet e parashikuara nga legjislacioni kombëtar për punëtorët jashtë burgut.*

*26.15 Orët maksimale të punës në ditë dhe në javë për të burgosurit përcaktohen në përputhje me legjislacionin vendas ose rregullat që rregullojnë punësimin e punëtorëve të lirë.*

*26.16 Të burgosurit kanë të paktën një ditë pushimi në javë dhe kohë të mjaftueshme për arsimim dhe veprimtari të tjera”.*

Në analizë të sa më sipër, personat e dënuar që punojnë punë të ndryshme brenda organikës së burgut duhet të shpërblehen me pagë minimale, sipas kriterëve të përcaktuara me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave. Në interpretim të parashikimeve ligjore, ata konsiderohen “punëmarrës” dhe duhet të trajtohen në përputhje me Kodin e Punës së Republikë së Shqipërisë, të ndryshuar; pasi megjithëse aktualisht në burgje punojnë një numër i konsiderueshëm i personave të dënuar me burgim, ata nuk trajtohen nga administrata e burgjeve njësoj si shtetasit e tjerë të punësuar jashtë burgut. Kjo sa i takon punësimin dhe trajtimin të tyre gjatë kësaj marrëdhënieje, apo sa i takon të drejtës për mbrotjen e shëndetit dhe sigurisë në punë, kohëzgjatjes së punës, shpërblimit për punën, ditët e pushimit, etj.

Neni 49, pika 2, e Kushtetutës së Shqipërisë, përcakton se: *“Të punësuarit kanë të drejtën e mbrojtjes shoqërore të punës”.*

Ndërsa, në nenin 52, pika 1, të saj është sanksionuar se: *“Kushdo ka të drejtën e sigurimeve shoqërore në pleqëri ose kurështë i paaftë për punë, sipas një sistemi të caktuar me ligj”.*

Dinjiteti i njeriut është një vlerë themelore kushtetuese<sup>11</sup>. Një shoqëri demokratike bazohet në dinjitetin e njeriut dhe parimin e barazisë së gëzimit të të drejtave themelore nga të gjithë individët.

Kjo është në të njëjtën frymë me parashikimet ligjore të LMD-së<sup>12</sup>. Ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen kundër diskriminimit”, është një ligj që rregullon zbatimin dhe

---

<sup>11</sup>Në Preambulën e Kushtetutës deklarohet: *“Pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij, dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare, bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t’i respektojë dhe t’i mbrojë”.*

<sup>12</sup>Referuar nenit 3, pika 8, e ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

respektimin e parimit të barazisë, si dhe përcakton shkaqet në bazë të cilave ndaj një personi apo një grupi personash, mund të ketë diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë.

Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 3/1, parashikon se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”*.

Gjithashtu në nenin 12, pika 1, germa b) parashikon se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”*.

Referuar korrespondencës zyrtare me DPB-në, Komisioneri vlerëson iniciativat ligjore të ndërmarra prej saj, lidhur me hartimin dhe përcjelljen në adresë të Ministrisë së Drejtësisë për konsultim të mëtejshëm të Projekt-VKM-së “Për nxitjen dhe shpërblimit të punës të burgosurve”<sup>13</sup>. Për hartimin e këtij projekt-vendimi, DPB është konsultuar me bazën ligjore ekzistuese që rregullon marrëdhëniet e punës në Republikën e Shqipërisë, si dhe Rekomandimet e Këshillit të Evropës mbi punësimin në sistemin e burgjeve. Në relacionin përmbledhës të këtij projekt-vendimi theksohet se DPB është e angazhuar që të sigurojë një gamë të gjerë të programeve ndërhyrëse të para dhe pas lirimit për personat në konflikt me ligjin, të cilat janë të fokusuara në sigurinë e komunitetit dhe parandalimin e krimit nëpërmjet kontrollit, mbikëqyrjes, rehabilitimit dhe përgatitjes për ri-integrim të kësaj kategorie, si dhe për t’u siguruar të burgosurve mundësi që të mos jenë pjesë e ciklit të papunësisë dhe si pasojë, të mund të zvogëlojnë riskun për recidivizëm.

---

<sup>13</sup>Referuar shkresës me nr.1969 prot., datë 09.03.2017 dhe relacionin bashkëngjitur shkresës.

Komisioneri vlerëson qëllimin e këtij projekt-vendimi për përcaktimin e rregullave, kritereve dhe procedurave të punësimit të të dënuarve dhe të paraburgosurve, për maksimalizimin e potencialeve të aftësisë profesionale dhe punësimit, duke rritur mundësitë për punësim, brenda dhe jashtë sistemit penitenciar, gjatë dhe pas lirimit nga burgu. I jepet rëndësi kështu dhe mundësisë për lidhje produktive me tregun e punës dhe punëdhënësit, si dhe një shpërblimi të drejtë për punën e kryer, për t'iu dhënë të burgosurve mundësi më të mira të zhvillimit të aftësive të tyre, të cilat përputhen me tregun e punës.

Komisioneri, pas konsultimit këtij projekt-vendimi vlerëson gjithashtu përcaktimin e rregullave, kritereve, si dhe procedurave të punësimit të të dënuarve dhe të paraburgosurve, në përputhje me parashikimet ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare; dhe njëherësh vlerëson si të nevojshëm ndërhyrjen apo rregullimin e disa parashikimeve të këtij projekt-vendimi, në përputhje edhe me parashikimet ligjore të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Lidhur me këtë, Komisioneri ka bërë rekomandime specifike të cilat i bashkëngjiten këtij vendimi.

Neni 7, pika 1, e ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” parashikon se: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.*

Në këtë kuadër, Komisioneri, konstaton se të personat që vuajnë dënimin në burgje apo ndodhen në paraburgim dhe janë të punësuar pranë këtyre institucioneve, janë vënë në pozita jo të favorshme krahasuar me kategorinë e punonjësve që punojnë dhe ndodhen jashtë këtyre institucioneve; duke iu mohuar atyre mundësinë për të përfituar sipas parashikimeve ligjore respektive.

Konstatohet se, DPB ka informuar Komisionerin lidhur me hapat e ndërmarra prej tyre në zgjidhje të kësaj problematike, si dhe ka vënë në dispozicion dokumentacionin lidhur me procedurën e ndjekur prej tyre për hartimin e Projekt-Vendimit “Për nxitjen dhe shpërblimit të punës të burgosurve”.

Komisioneri duke vlerësuar si hap pozitiv hartimin e projekt-vendimit përse i përket krijimit të mundësive reale për punësimin e të burgosurve dhe trajtimin e tyre në përputhje me parashikimet ligjore sa i takon përfitimeve nga puna e tyre, ka bërë edhe sugjerimet/rekomandimet përkatëse, sipërcituar në vendim.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 3, pika 1, nenin 7, pika 1, nenin 12, pika 1, germa c), 32, pika 1, germa a) dhe, nenin 33, pikat 9 dhe 10 të Ligjit nr. 10 221/2010 “Përmbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nenit 90, pika 2, të Kodit të Procedurës Administrative,

### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e diskriminimit të drejtëpërdrejtë të të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, për shkak të gjendjes së tyre sociale (si të dënuar) në fushën e punësimit, në raport me punonjësit e tjerë jashtë burgjeve.
2. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Ministria e Drejtësisë dhe Këshilli i Ministrave; të mbajnë parasysh rekomandimet e Komisionerit për ndryshimet dhe shtesat e sugjeruara në Projekt-Vendimin “Për nxitjen dhe shpërblimit të punës të burgosurve”.
3. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Ministria e Drejtësisë, brenda 30 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi, të informojnë Komisionerin lidhur me masat e ndërmarra prej tyre, për sa më sipër.
4. Në referim të nenit 33, pika 13, të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në gjykatë, brenda afateve ligjore.

**Irma BARAKU**

---

**KOMISIONERI**

(shkaku: gjendja shoqërore)

(fusha: të mira dhe shërbime)